

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Zonja Zhupa, unë ju falënderoj që ju i lexoni statuset e mia dhe njoftimet që nxjerr, sepse ditën e djeshme kam bërë një takim me Komitetin e Maturës Shtetërore, me mësues, me drejtues të institucioneve arsimore, ku kam prezantuar gjetjet dhe propozimet e grupit të punës, të ngritur në tetor të vitit të kaluar, për reformimin e maturës me qëllim përmirësimin e këtij procesi! Në fakt, grupi i punës na i solli propozimet në prill, por ne, për të mos ndikuar në procesin e maturës së këtij viti, për të mos i bërë konfuz maturantët, menduam që këto propozime t'i bëjmë pas provimeve të maturës.

Ndaj, dje zhvilluam një takim, ku prezantuam tri propozime, një prej të cilëve është ky që thoni ju, që nga rregullorja të hiqet neni që nuk lejon rivlerësimin e testit. Në të gjithë historinë e Maturës Shtetërore, edhe në kohën tuaj, edhe në kohën tonë, asnjëherë nuk ka pasur rivlerësim testi. Pra, rivlerësimi i testit ka qenë gjithmonë i ndaluar, sepse koha nga përfundimi i provimeve të maturës deri kur maturantët plotësojnë formularin për të shkuar universitetin është shumë e shkurtër dhe është e pamjaftueshme. Sikur të gjithë mësuesit e Shqipërisë të aktivizojmë për të rikorrigjuar testet, është e pamundur të bëhet. Janë 30 mijë maturantë që bëjnë katër provime mature dhe për të bërë rivlerësimin e testeve duhet një kohë që më pas do të vonojë procesin për të aplikuar në universitete.

Kjo ka qenë arsyeja që edhe ju, edhe ne, të gjithë bashkë, prej 15 vjetësh kemi lënë në rregullore një pikë ku thuhet se nuk lejohet rivlerësimi i testit. Pra, nuk e kemi shtuar ne, atje ka qenë gjithmonë. Unë jam plotësisht dakord me ju dhe këtë e kam deklaruar edhe në takimin që zhvilluam me Komitetin e Maturës Shtetërore, që sot ankimohen vendimet e gjykatave dhe çdolloj vendimi, ndaj ne duhet të bëjmë një përpjekje për t'u dhënë të drejtën maturantëve që t'u rivlerësohet testi. Ky ka qenë propozimi që ne diskutuam dje. Të gjithë jemi dakord që duhet të ketë rivlerësim testi, por ne duhet të gjejmë mënyrën për t'u bërë, për të mos u bërë pengesë që maturantët ta tërheqin diplomën në kohën e duhur.

Problemi është sa kohë do të marrë ky proces, sepse të gjithë maturantët e kanë këtë të drejtë. Në përgjithësi maturantët dhe prindërit e tyre kanë gjithmonë tendencën të thonë: unë i kam bërë të gjitha, kështu që ma rivlerësoni testin. Gjithsesi, unë jam plotësisht dakord me ju që testi duhet të rivlerësohet, e kam deklaruar dje, e keni në faqen time zyrtare në facebook, në media, dhe ne do të gjejmë patjetër një mënyrë si t'ua japim maturantëve këtë të drejtë. Faleminderit!